



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:196734

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05862079

KF.nr.354/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtaren Vera Gashi Bala, në çështjen juridike të paditësit F.K., me numër fiskal 600755906 dhe adresë rr. “...” Podujevë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, në seancën përgatitore të datës 24.06.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë/Departamenti Fiskal SHPALLET JO KOMPETENT në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë të ushtruar nga paditësi F.K. nga Podujeva.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda së bashku me shkresat e saj, i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Paditësi F.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar, XH.T., me datë 03.09.2021 ka ushtruar padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e raportit të kontrollit të ATK-së të datës 05.05.2021.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 24.06.2024 dhe të njëjtën e ka mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse. Paditësi edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi, ndërsa e paditura me parashtrësën e datës 04.06.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të merr

pjesë në këtë seancë, andaj gjykatës i ka kërkuar që të vepron në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 i LKA-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe thënieve të paditësit si në padi, e në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së si dhe nenet 11, par. 2 dhe 13 të ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, shqyrtoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe vlerësoi se Dhomat e Shkallës së Parë/Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë lëndë.

Për të vlerësuar kompetencën, Gjykata fillimisht iu referua Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e i cili ligj në nenin 11, paragrafi 2, përcakton se *“Dhomat e Shkallës së Parë janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet në juridiksionin e Gjykatës Komerciale”*, dhe nenit 13, par 4 me të cilin taksativisht përcaktohet se *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal”*.

Gjykata, vlerësimin se kjo çështje nuk bie në kompetencë të Departamentit Fiskal të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, e ka bazuar në atë se, paditësi nuk e gëzon cilësinë e ndonjë shoqërie tregtare, por ka cilësinë e personit fizik dhe i njëjti nuk është i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Kompetenca e Departamentit Fiskal është e rregulluar me nenin 13 paragrafi 1.11 të Ligjit nr.08/L019 për Gjykatën Komerciale, me të cilin shprehimisht është përcaktuar se Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së parë - Departamenti Fiskal është kompetent të vendos për: *“kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore;”*

Ndërsa, përkufizimin e shoqërive tregtare shprehimisht e përcakton neni 3 par 1.22 i Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, sipas të cilit: *“Shoqëria Tregtare është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji apo të një ligji tjetër siç është përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 i këtij*

ligji, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare” . Tutje neni 5 par 3 i të njëjtit ligj përcakton se: “Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Forma e organizimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera rregullohen në ligjin përkatës më të cilin krijohet Shoqëria Tregtare ose subjekti përkatës. Dispozitat e ligji të veçantë që rregullojnë këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera, duke përfshirë dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji” . Ndërsa llojet e Shoqërive Tregtare janë të përcaktuara me nenin 5 par 1 të po të njëjtit, sipas të cilit: “Një Shoqëri Tregtare mund të themelohet në Kosovë si Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare”, po ashtu me par 3 të të njëjtit nen përcaktohet se “Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Forma e organizimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera rregullohen në ligjin përkatës më të cilin krijohet Shoqëria Tregtare ose subjekti përkatës. Dispozitat e ligji të vecantë që rregullojnë këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera, duke përfshirë dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji. ”

Në rastin konkret, paditësi F.K., nuk gëzon cilësinë e asnjërës prej këtyre llojeve të shoqërive tregtare, e as të ndonjë shoqërie tjetër tregtare të paraparë me ndonjë ligj të veçantë. I njëjti, po ashtu nuk është i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës. Paditësi ka cilësinë e personit fizik të cilit për qëllime tatimore, ATK-ja i ka vendosur numrin fiskal: 600755906. Fakti, se të njëjtit i është vendosur numri fiskal, nuk përbën element për të cilësuar si shoqëri tregtare të njohur sipas Ligjit Nr. 06/L 016 për Shoqëritë Tregtare, e as ndonjë shoqërie tjetër tregtare të paraparë me ndonjë ligj të veçantë.

Rrjedhimisht, Dhomat e Shkallës së Parë/ Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, duke u bazuar në nenet 19, dhe 23, par 1, të LPK-së, si dhe neneve 11, par 2, 13, par 1, nënpar 1.11, dhe par 2 të këtij neni të Ligjit mbi Gjykatën Komerciale 08/L-015, konstatoi që kjo çështje juridike nuk bie në kompetencën lëndore të kësaj gjykate.

Nga të cekurat më lart e komfor Nenit 387.1 pika (u) dhe Nenit 392 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.354/22, datë 24.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, Dhomave të Shkallës së Dytë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.